

**Raport Monitorimi i realizimit të zbatimit të
Planit të Integritetit 2024
Bashkia Himarë**

Tabela e përmbajtjes

I.	Hyrje	3
II.	Metodologjia e vlerësimit	4
III.	Monitorimi i zbatueshmërisë të planit të integritetit.....	4
IV.	Konkluzione dhe Rekomandime.....	14
V.	Hapa të tjerë.....	14

Lista e Figurave

Figura 1: Shkalla e realizimit të plotë të masave/aktivitetëve janar-dhjetor 2024.....	5
Figura 2; Grafiku i zbatimit të masave janar-dhjetor 2024.....	6
Figura 3: Objektivi I “Menaxhimi i burimeve njerëzore të bashkisë me qëllim forcimin e rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit”, grafiku i realizimit të masave/aktivitetëve janar-dhjetor 2024.....	8
Figura 4 : Objektivi II “Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe strategjik të bashkisë në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit”, grafiku i realizimit të masave/aktivitetëve janar-dhjetor 2024..	10
Figura 5 : Objektivi III “Përmirësimi i transparencës proaktive të bashkisë për të mundësuar rritjen e llogaridhënies dhe aksesit të qytetarëve në informacion”, grafiku i realizimit të masave/aktivitetëve janar-dhjetor 2024.....	11
Figura 6 : Objektivi IV “Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë”, grafiku i realizimit të masave/aktivitetëve janar-dhjetor 2024.....	13

I.Hyrje

Integriteti institucional dhe lufta kundër korrupsionit konsiderohen si një nga prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare. Në kontekstin e sektorit publik, integriteti nënkupton përmbushjen e detyrimeve për transparencë, llogaridhënie, etikë, ndershmëri, efektivitet dhe efikasitet në kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e funksioneve rregullatore dhe administrative.

Në nivelin e qeverisjes vendore, zbatimi dhe monitorimi i politikave kundër korrupsionit është konkretizuar përmes koordinimit dhe zbatimit të nismave antikorrupsion të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2015-2023, e cila vijon me Strategjinë e re 2024-2030 dhe Planin e Veprimit 2024-2026, të miratuara me Vendimin nr. 859, datë 26.12.2024.

Menaxhimi i riskut të integritetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) përfaqëson një proces të rëndësishëm, i cili mbështetet në a Qëllimin e parë të Politikës: Parandalimi i korrupsionit, dhe konkretizohet në Objektivin Specifik 1.4: Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky proces kontribuon gjithashtu në realizimin e Qëllimit Politik 5 të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2023 (SNDQV): “Forcimi i demokracisë vendore dhe përparimi i agjendës së integritetit evropian në nivel vendor, Objektivi Specifik 5.2: “Nxitja e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor dhe konsolidimi i mëtejshëm i arritjeve mbi integritetin”, miratuar me VKM nr.252, datë 21.04.2023.

Ky proces është gjithashtu në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian (2018) për Shqipërinë në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian, ku ndër rekomandimet e dhëna theksohet zbatimi i dokumentit të Strategjisë Kundër Korrupsionit, duke iu referuar konkretisht mungesës së një sistemi funksional për menaxhimin e integritetit në institucionet publike të vendit.

Procesi i menaxhimit të riskut të integritetit në nivel vendor zbatohet përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, që përfshin të gjitha strukturat e brendshme të bashkisë. Hapi i parë i këtij procesi është hartimi i Planit të Integritetit për njësinë vendore, detajuar edhe me një Plan Veprimi trevjeçar. Monitorimi dhe raportimi i këtij plani përbëjnë etapën tjetër të menaxhimit të riskut në bashki. Monitorimi zhvillohet periodikisht (çdo vit) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga punonjësit dhe drejtuesit e bashkisë për zbatimin e masave të miratuara për trajtimin e risqeve, në përputhje me përgjegjësitë që ata mbajnë.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), në kuadër të funksioneve të saj për realizimin e objektivave të Qeverisë Shqiptare për garantimin e qeverisjes së mirë, ka vijuar procesin e monitorimit të zbatimit të Planeve të Integritetit në nivel bashkie për vitin 2024.

II. Metodologjia e vlerësimit.

Ky raport është hartuar sipas metodologjisë së miratuar me **Urdhrin nr.553, datë 30.09.2021**, “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore”. Vlerësimi është realizuar nëpërmjet analizës së të dhënave dhe matjes së progresit në zbatimin e masave të përfshira në Planin e Veprimit për këtë periudhë raportimi.

III. Monitorimit i zbatueshmërisë të Planit të Integritetit për vitin 2024.

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Himarë për vitin 2024 përbën dokumentin e tretë të hartuar në përputhje me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.553, datë 30.09.2021.

Në Planin e Integritetit të bashkisë janë përcaktuar gjithsej katër objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk, si dhe janë planifikuar masat dhe aktivitetet për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** “Menaxhimi i burimeve njerëzore të bashkisë me qëllim forcimin e rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit”
- **Objektivi II** “Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik për aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit”;
- **Objektivi III** “Përmirësimi i transparencës proaktive të bashkisë për të mundësuar rritjen e llogaridhënies dhe aksesit të qytetarëve në informacion”;
- **Objektivi IV** “Menaxhimi i riskut të integritetit me fokus në fushat e përgjegjësisë së bashkisë”;

Plani i Integritetit është konceptuar për t’u zbatuar përgjatë një periudhe trevjeçare, konkretisht 2022-2025.

Për Bashkinë Himarë, Plani i Integritetit për periudhën janar-dhjetor 2024, referuar Planit të Veprimit, përmban masa dhe aktivitete të planifikuara në mbështetje të objektivave të planifikuara në Planin e Veprimit.


Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Himarë për periudhën janar – dhjetor 2024, rezulton si më poshtë:

Nga procesi i monitorimit rezulton se, në totalin prej 21 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2024:

- 14 masa/aktivitete janë realizuar plotësisht, që përfaqëson 66% të totalit
- 3 masa/aktivitete janë në process realizimi, ose 15 %
- 4 masa/aktivitete mbeten të porealizuara, ose 19 %


Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun vijues.

Figura 1 : Shkalla e realizimit të plotë të masave/aktiviteteteve janar-dhjetor 2024.



Bashkia	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete në proces	Masa dhe aktivitete të përealizuara
Himarë					
Realizimi ne total i objektivave të PI		21	13	7	1

Figura 2: Grafiku i zbatimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2024.



Sa më sipër, gjatë vitit 2024, Bashkia Himarë ka ndërmarrë një sërë hapash të rëndësishëm në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Në këtë kuadër, janë hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike që adresojnë forcimin e etikës dhe integritetit, përmirësimin e funksionimit të strukturave vendore antikorrupsion, konsolidimin e kuadrit të brendshëm institucional, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit, si dhe përmirësimin e transparencës dhe të besueshmërisë publike.

Qasja Vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të bashkisë përmban një analizë të përgjithshme mbi zbatueshmërinë dhe progresin e arritur gjatë vitit 2024, në lidhje me aktivitetet dhe masat për menaxhimin e riskut në fusha të veçanta të përgjegjësisë. Raporti vlerëson gjithashtu përputhshmërinë me kuadrin rregullator dhe ndikimin e masave të ndërmarra në përmirësimin e performancës institucionale dhe forcimin e kapaciteteve për të parandaluar dhe për të rezistuar ndaj shkeljeve të integritetit.

Metodologjia e vlerësimit.

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të dhënë nga drejtoritë dhe strukturat teknike të bashkisë, bazuar në aktivitetet dhe masat e parashikuara për zbatim për vitin 2024, sipas Planit të Veprimit të Planit të Integritetit

Mbledhja dhe analiza e të dhënave.

Të dhënat për hartimin e këtij raporti janë mbledhur nga Koordinator i Integritetit të bashkisë, në përmbushje të rolit të tij si strukturë e posaçme përgjegjëse për mbledhjen dhe analizën e informacionit mbi ecurinë e raportit të monitorimit.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I “Menaxhimi i burimeve njerëzore të bashkisë me qëllim forcimin e rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit”.

Ky objektivi synon të përforcojë, mirëfunksionimi i administratës së institucionit nëpërmjet forcimit të kapaciteteve njerëzore, trajnimit dhe rekrutimit të stafit të nevojshëm në përputhje me strukturën dhe organikën, sanksionimit të procedurave të qarta të të gjitha proceseve të punës në njësitë e bashkisë.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2024 janë planifikuar për t’u realizuar gjithsej 10 masa/aktivitete, nga të cilat

- Janë realizuar 7 masa/aktivitete ose 70 %
- Nuk janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 30 %

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë:

Objektivi I	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të porealizuara
Menaxhimi i burimeve njerëzore të bashkisë me qëllim forcimin e rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit		10	7	0	3

Figura 3: **Objektivi I** “Menaxhimi i burimeve njerëzore të bashkisë me qëllim forcimin e rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit”, grafiku i realizimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2024.



Për periudhën e monitorimit janar- dhjetor 2024, ky objektivi është realizuar në masën **70 %**, me zbatimin e masave /aktiviteteve si më poshtë:

- Personeli i bashkisë i informuar për zhvillimin profesional, ngritjen në detyrë si dhe përshkrimet e punës;
- Hartimi i planeve vjetore të punës për të gjitha drejtoritë e bashkisë;
- Njohja e Titullarit me planet vjetore të punës;
- Informimi i personelit me planet e punës;
- Informimi i punonjësve mbi rregulloren e sinjalizuesit dhe vënia e saj në dispozicion;
- Rikujtesë periodike e punonjësve mbi kontaktin e sinjalizuesit;
- Publikimi i informacionit për njësinë e sinjalizimit dhe kontaktet e saj në Programin e Transparencës;

Objektivi II “Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik për aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit”.

Ky objektivi synon të forcojë strukturat dhe mekanizmat që funksionojnë në nivelin e vetëqeverisjes vendore, të cilat kontribuojnë në rritjen e integritetit institucional dhe veprojnë si instrumente antikorrupsion. Këto struktura dhe mekanizma ngrihen dhe funksionojnë në përputhje me kornizën ligjore për vetëqeverisjen vendore, të drejtën e informimit, konsultimin publik,

menaxhimin dhe kontrollin financiar, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, parandalimin e konfliktit të interesit, etj.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objekti, për vitin 2024 janë planifikuar për t'u realizuar gjithsej 2 masa/aktivitete, nga të cilat

- Janë realizuar 1 masa/aktivitete ose 50 %
- Janë në proces 1 masa/aktivitete ose 50%

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Objektivi II	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara per vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht tërealizuara	Masa dhe aktivitete te porealizuara
Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik për aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit		2	1	1	0

Figura 4 : **Objektivi II** “Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe strategjik të bashkisë në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit”, grafiku i realizimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2024.



Për periudhën e monitorimit janar- dhjetor 2024, ky objektivi është realizuar në masën **50%**, me zbatimin e masave /aktiviteteve si më poshtë:

- Janë realizuar konsultimet me publikun;

Objektivi III “Përmirësimi i transparencës proaktive të bashkisë për të mundësuar rritjen e llogaridhënies dhe aksesit të qytetarëve në informacion”

Ky objektivi synon forcimin e llogaridhënies publike dhe transparencës në bashki, duke përmirësuar transparencën proaktive të institucionit, nëpërmjet plotësimit dhe përditësimit të rregullt të Programit të Transparencës. Përmirësimi i këtyre proceseve do të ndikojë në rritjen e besimit të publikut dhe përfshirjen e tij në veprimtarinë e bashkisë duke shfrytëzuar aksesin e shtuar në informacion.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2024 është planifikuar për t’u realizuar gjithsej 1 masë/aktivitet

- Është realizuar masa/aktiviteti ose 100 %

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë:

Objektivi III	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara per vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të porealizuara
Përmirësimi i transparencës proaktive të bashkisë për të mundësuar rritjen e llogaridhënies dhe aksesit të qytetarëve në informacion		1	1	0	0

Figura 5 : **Objektivi III** “Përmirësimi i transparencës proaktive të bashkisë për të mundësuar rritjen e llogaridhënies dhe aksesit të qytetarëve në informacion”, grafiku i realizimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2024.



Për periudhën e monitorimit janar- dhjetor 2024, ky objektivi është realizuar në masën **100 %**, me zbatimin e masave /aktiviteteve si më poshtë:

- Përditësimi i faqes zyrtare të Bashkisë me informacionin e plotë të procedurave dhe kritereve për lejet/licensat.

Objektivi IV “Menaxhimi i riskut të integritetit me fokus në fushat e përgjegjësisë së bashkisë”

Ky objektivi synon adresimin e risqeve të integritetit në fushat funksionale të përgjegjësisë së bashkisë. Masat e parashikuara synojnë të përmirësojnë efektivitetin, eficientësinë dhe cilësinë e proceseve të punës në fushat funksionale të bashkisë, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike, planifikimin e territorit, menaxhimin e pronave dhe aseteve publike, menaxhimin financiar, etj.


Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të këtij objektivi, për vitin 2024 janë planifikuar për t’u realizuar gjithsej 8 masa/aktivitete, nga të cilat

- Janë realizuar 5 masa/aktivitete ose 63 %
- Janë në proces realizimi 2 masa/aktivitete ose 25%
- Nuk është realizuar 1 masë/aktivitet ose 12 %

Rezultatet janë paraqitur në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Objektivi IV	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara per vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të porealizuara
Menaxhimi i riskut të integritetit me fokus në fushat e përgjegjësisë së bashkisë		8	5	2	1

Figura 6 : Objektivi IV “Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjesisë së bashkisë”, grafiku i realizimit të masave/aktiviteteve janar-dhjetor 2024.



Për periudhën e monitorimit janar- dhjetor 2024, ky objektivi është realizuar në masën **63 %**, me zbatimin e masave /aktiviteteve si më poshtë:

- Kryerja e analizës mbi shkaqet që krijojnë vështirësi në vjeljen e taksave dhe tarifave vendore dhe marrja në konsideratë gjatë rishikimit të paketës fiskale dhe dorëzimi i saj në Këshillin Bashkiak ;
- Përditësimi i bazës së të dhënave të bashkisë për paketën fiskale dhe dhënia e aksesit të personelit përkatës në këtë bazë të dhënash;
- Marrja e masave administrative mbi detyrimet e prapambetura të aktiviteteve sezonale
- Ngritja e Komisioneve për asgjësimin e aseteve që e kanë humbur vlerën e tyre në respektim të dispozitave ligjore të kontabilitetit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aseteve;
- Vlerësimi periodik i nevojës së ruajtjes së dokumenteve bazuar në legjislacionin për arkivat;

IV. Konkluzione dhe Rekomandime.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese *janar-dhjetor 2024*, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezultojnë se:

Bashkia Himarë ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel mesatar realizimi prej 66 % të masave të planifikuara për vitin 2024 (në intervalin 61-80%). Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate pozitive në:

- Ngritjen e kulturës së integritetit dhe llogaridhënies në bashki;
- Transparencë më e lartë në publikimin e informacioneve;
- Trajnime dhe aktivitete që mbështesin etikën institucionale;
- Ndërmarrja e të gjithë masave administrative dhe ligjore për vjeljen e detyrimeve të pashlyera të të tretëve ndaj bashkisë;

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e shkallës së transparencës së institucionit. Si rezultat, një sërë dokumentesh strategjike, aspekte të punës dhe të shërbimeve të ofruara, rezultatet e kontrolleve financiare, si dhe instrumentet për raportimin e korrupsionit apo shkeljeve të tjera, janë bërë të aksesueshme online në adresën zyrtare të bashkisë. Ky progres e ka renditur këtë indikator në vend të parë duke e pozicionuar bashkinë në një nivel proaktiv të integritetit dhe llogaridhënies.

V. Hapa të tjerë:

- Zgjerimi i trajnimeve dhe fushatave ndërgjegjësuese, me fokus në parandalimin e sjelljeve që çënojnë integritetin;
- Forcimi i zbatimit të masave për transparencë dhe përmirësimi i kuadrit rregullator, me synim rritjen e integritetit në menaxhimin financiar, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe administrimin e aseteve;
- Rritja e pjesëmarrjes qytetare dhe nxitja e sinjalizimit, përmes krijimit të kanaleve efektive dhe anonime për denoncime;
- Të vijojë puna për hartimin dhe miratimin e strategjisë për administrimin e pronave të bashkisë;
- Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, për një raportim më të rregullt mbi masat e Planit të Integritetit;
- Sigurimi i një raportimi periodik transparent, përmes publikimit të raporteve 6-mujore mbi zbatimin e Planit të Integritetit;